





NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#87

Botohet “Politika Shtetërore për Diasporën 2020”



Botohet libri “Politika Shtetërore për Diasporën 2020”. Ai është përmbledhje e dokumenteve dhe akteve në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Ky libër është një botim vjetor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Libri “Politika Shtetërore për Diasporën 2020” është botimi i tretë vjetor. Ai është publikimi pasardhës i librave “Politika Shtetërore për Diasporën 2018” dhe “Politika Shtetërore për Diasporën 2019”. Libri “Politika Shtetërore për Diasporën 2020” është një tregues i ecursisë së zbatimit të politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për Diasporën shqiptare gjatë vitit 2020. Dokumentet e përfshira në Librin “Politika Shtetërore për Diasporën 2020” shërbejnë për informimin e publikut brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e veprimtarisë së institucioneve shtetërore si edhe legjislacionin e ri për interesat e diasporës shqiptare.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Marrëveshja për pensionet Shqipëri-Itali, Ministri Majko: Gati të bisedojmë



Shoqata “Volare” në Itali organizoi një takim virtual mbi çështjen e pensioneve ku temë e diskutimit ishte “A do të bëhet marrëveshja? E drejta e pensionit”. Në këtë takim në thelb ishte problematika e kontributeve që derdhen shtetasit shqiptarë në Itali dhe e drejta e përfitimit të pensionit. Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko shprehu vullnetin e palës shqiptare për të zgjidhur këtë çështje. “Përgjigja ime është e thjeshtë: Nesër, ne jemi gati të bisedojmë për këtë. Sepse komuniteti shqiptar në Itali është ndër më të mëdhenjtë që Shqipëria ka jashtë vendit dhe presioni është normal, është i lartë. Kjo është arsyeja që kohë pas kohe kemi komunikuar me kolegë në Romë”, u shpreh ministri Majko. Takimi u moderua nga Geri Ballo, aktiviste dhe një nga themelueset e shoqatës “Volare. Takime dhe diskutime mbi çështjen e pensioneve dhe kontributeve që shqiptarët kanë derdhur në Itali janë diskutuar edhe më parë nga kjo shoqatë.



Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

rrjetiprofesionisteve.al

Roli në shtetin amë, Ministri Majko: Diaspora, moment i rëndësishëm i identitetit kombëtar



“Roli i Diasporës shqiptare në çështjen kombëtare” ishte temë e një paneli të realizuar online në ditën e Pavarësisë, të organizuar nga Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Shtutgart. I pranishëm në këtë panel, ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko tha se tashmë ka ardhur momenti që të mos diskutohet thjesht roli i diasporës në sensin e distancës, pasi po vijnë kohë sfiduese. “Tani ka ardhur momentin që ne të mos diskutojmë thjesht rolin e saj në sensin e distancës, mendoj që kohët që po vijnë, po vijnë jashtëzakonisht sfiduese por edhe me një cilësi me shumë përfitim për mënyrën se si kombi shqiptar është shpërndarë në disa shtete dhe me një numër të jashtëzakonshëm në Diasporë”, tha ministri Majko. Ai shtoi më tej se tashmë ka nisur dhe zgjimi i komuniteteve, ku si shembull mori çeljen e qendrës për arbëreshët në Shqipëri e cila do të krijojë indikacione për të ringjallur një lidhje të veçantë me këtë komunitet.




Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

adld.al

Anëtarja e KKD, Brikena Muharremi në aktivitetin për sfidat dhe fuqizimin e gruas



Sfidat dhe fuqizimi i gruas në shoqëri ishte tema e takimit “Successful Mothers” pjesë e së cilës ishte dhe anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Brikena Muharremi. Ky aktivitet u organizua për Ditën e Flamurit nga organizatat “Shpresa Programme” dhe “Successful Mothers”. Pjesëmarrës në takimin e organizatës Shpresa ishin edhe Ambasadori i Shqipërisë në Britani, Qirjako Qirko, e Ngarkuara me Punë e Ambasadës së Kosovës, Arrita Gjakova, zyrtarë britanik dhe përfaqësues të komunitetit shqiptar. Muharremi u shpreh lidhur me çështjen e diasporës dhe votën e shtetasve shqiptarë jashtë vendit.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

Klasikët dygjuhësh, QBD publikon “Ushtari prej Plumbi” dhe “Borëbardha”



Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar në faqen online të saj botimin e radhës të kolanës klasikët dy gjuhësh, përrallat në shqip dhe anglisht “Ushtari prej Plumbi” dhe “Borëbardha”. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiçi është i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese “Ushtari prej Plumbi” shkruar nga autori Peter Holeinone, është historia e një ushtari prej plumbi, i cili megjithëse ishte derdhur në metal si shokët e tij, tregoi se kishte një zemër të ndjeshme. Fundi i tij dhe balerinës, ndryshon aq shumë nga përrallat e tjera. “Borëbardha”, përralla më e famshme e Vëllezërve Grimm në të gjithë botën, vjen për lexuesit e vegjël në këtë libër në shqip dhe në anglisht.

"Raporto" problemin në çdo kohë në AmbasadaIme



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)